

## **RADIOCHEMICAL AND RADIOBIOLOGICAL EVALUATION OF A NEW SERIES OF BOMBESIN DERIVATES**

### **VLERESIMI RADIOKIMIK DHE RADIOPHARMACEUTIK I NJE SERIE TE RE TE DERIVATEVE TE BOMBESINES**

\*<sup>a</sup>ELIDA BYLYKU, <sup>a</sup>BRUNILDA DACI, <sup>a</sup>SKENDER MALJA, <sup>b</sup>DAMIANA OSMALLI

<sup>a</sup>Qendra e Fizikes Berthamore te Zbatuar, Universiteti i Tiranes

<sup>b</sup>Instituti i Shendetit Publik

elidabylyku@yahoo.co.uk

**AKTET V, 1: 87-91, 2012**

#### **PERMBLEDHJE**

Ne vazhdim te drejtimit te perqatitjes se radiofarmaceutikateve te reja per diagnostikimin dhe terapine e kancerit te pankreasit, kemi studiuar një seri te re derivateve te Bombesines. Keto derivate formojnë komplekse me radiometalin  $^{99m}\text{Tc}$ , i cili eshte ideal per qellime diagnostikuese. Perpjekjet tona janë fokusuar ne vleresimin krahasues te kushteve te radioshenimit te ketyre derivateve te bombesines me  $^{99m}\text{Tc}$ , duke percaktuar kushtet optimale te shenimit. Eshte realizuar studimi radiokimik dhe qendrueshmeria e produkteve te fituara ne temperature dhome dhe  $-4^\circ\text{C}$ , me metoden kromatografike HPLC. Gjithashtu eshte kryer studimi i biodisperndarjes ne minj normal dhe me tumore te injektuar. Rezultatet e ketij studimi treguan se seria e derivateve te reja te Bombesines shfaq veti kimike dhe biologjike te ngjashme me ato te Bombesines natyrore dhe keto derivate kane veti premtuese per tu perdonur per studime te kancerit dhe ne njerez.

**Fjalë kyçë:** Bombesin, kromatografi, pasterti radiokimike, shenim,  $^{99m}\text{Tc}$ .

#### **SUMMARY**

With the aim of preparing new radiopharmaceuticals for diagnosis and therapy of pancreas cancer, we have studied a series of new bombesin derivatives. These derivatives form complexes with the radimetall  $^{99m}\text{Tc}$  which is ideal for diagnosis purposes. Our efforts were focused on comparatively assessing the radiolabeling conditions of the Bombesin derivatives with  $^{99m}\text{Tc}$ , defining optimal conditions of labeling. It is performed radiochemical study and stability of the products in room temperature and  $-4^\circ\text{C}$ , using HPLC chromatographic method. There are also performed biodistribution studies in normal and inducted tumor mice. The results of this study indicated that the new series of Bombesin derivatives shows chemical and biological properties similar with native Bombesin and they are promising for human cancer studies.

#### **HYRJE**

Peptidet kane cilesi te favorshme per tu perdonur si gjurmues te radioshenuar per shkak te afinititet receptor te larte dhe pastrimit te shpejte nga plazma. [1] Mirepo ne kushte fiziologjike ato metabolizohen shpejt ne plazem nga peptidazat endogene duke perfunduar efektin e tyre biologjik. Perqendrimi i neuropeptideve te vogla ne tumore vjen si pasoje

e aftesise se ketyre biomolekulave per te lidhur receptoret e siperafqes se qelizave, te pranishme ne një numer te madh indesh tumorale malinj.[2] Ne perqatitjen e radiofarmaceutikateve me baze peptidet hapi i pare eshte perqatitja e komponimeve te cilat kane afinitet dhe selektivitet per organin qe na intereson dhe qe gjithashtu kane aftesi per te lidhur radioizotopin qe na intereson. Ne botimet shkencore jane

paraqitur perpjekje te medha te bera per te sintetizuar derivate te peptideve te afta per t'u lidhur me  $^{99m}\text{Tc}$  nepermjet ligandeve. [3,4]

Strategjia me e zakonshme eshte te fiksohet nje ligand ne nje nga aminoacidet fundore, shpesh nepermjet nje grupi hapesinor.

Nje peptid me interes eshte zgjedhur Bombesina (BN), nje neuropeptid i 14 aminoacideve, eshte nje tetradekapeptid me kete formule te per gjithshme:

[pGlu-Gln-Arg-Leu-Gly-Asn-Gln-Trp-Ala-Val-Gly-His-Leu-Met-NH<sub>2</sub>],

Ajo eshte nje analog i "gastrin releasing peptide" njerezore (GRP), qe lidhet ne receptoret GRP (GRP-R) me afinitet dhe specificitet te larte dhe njekohesht stimulon rritjen e tumoreve ne nje numer te konsiderueshem qelizash kanceri njerezore.[5] Bombesina e radioshenuar mund te perdoret me sukses per shintigrafine e receptoreve GRP. Akumulimi i larte i gjurmuesve diagnostik ne tumoret e paoperueshme eshte kriteri me i rendesishem per terapine radioizotopike te metejshme. Duke nderhyre dhe modifikuar molekulen e Bombesines eshte zgjidhur problemi i stabilitetit te ulet in vivo te saj. Permiresim i dukshem eshte realizuar nga futja ne molekulen e Bombesines te aminoacideve jonatyrale me grupe elektron-dhenese, te afta per te kompleksuar  $^{99m}\text{Tc}$  e reduktuar. Nga keto nderhyrje ne molekulen e Bombesines jane perftuar derivate qe shkurtimisht i paraqesim me X-Aca-BN, ku grupi metalik gelatues X eshte lidhur ne aminen fundore N me ane te acidit 6-amino-hekzanoik (Aca). [6] Struktura e pote e derivateve te perftuara :

**Gly-Gly-Cys-Aca-Gln-Arg-Leu-Gly-Asn-Gln-Trp-Ala-Val-Gly-His-Leu-Met(CONH<sub>2</sub>)** ) : **Gly-Gly-Cys-Aca-BN - (BN1.1)**

**MeGly-Gly-Cys-Aca-Gln-Arg-Leu-Gly-Asn-Gln-Trp-Ala-Val-Gly-His-Leu-Met(CONH<sub>2</sub>)** ) : **MeGly-Gly-Cys-Aca-BN - (BN1.2)**

**Me<sub>2</sub>Gly-Gly-Cys-Aca-Gln-Arg-Leu-Gly-Asn-Gln-Trp-Ala-Val-Gly-His-Leu-Met(CONH<sub>2</sub>)** ) : **Me<sub>2</sub>Gly-Gly-Cys-Aca-BN - (BN1.3)**

**MacGly-Cys-Aca-Gln-Arg-Leu-Gly-Asn-Gln-Trp-Ala-Val-Gly-His-Leu-Met(CONH<sub>2</sub>)** ) : **MacGly-Cys-Aca-BN - (BN1.4)**

ku: **MeGly** eshte metilglycine, **Me<sub>2</sub>Gly** eshte dimetilglycine dhe **Mac** eshte acid merkaptoacetik.

Pra ne molekulen e Bombesines natyrore eshte zevendesuar acidi piroglutamik (pGlu) me X-Aca qe mbart aminoacide te afta per t'u lidhur me radiometalin.

## MATERIALET DHE METODAT

### I. Studimi i shenimit te derivateve te Bombesines me $^{99m}\text{Tc}$

Shenimi i nje biomolekule sensitive kryhet nepermjet nje produkti te ndermjetem (precursor), i cili fillimisht lidhet me radioizotopin duke qene mbartesi i tij, dhe me pas ndodh reaksiuni i shkembimit te radioizotopit nga ky produkt i ndermjetem ne biomolekulen.

Ne rastin e derivateve te Bombesines ne studim, glukonati i natriumit i reduktuar me  $\text{SnCl}_2$  dhe i shenuar me  $^{99m}\text{TcO}_4^-$  eshte perdor si ligandi i ndermjetem i shkembimit te  $^{99m}\text{Tc}$ .

### Menyra e shenimit

Eshte homogjenizuar dhe ruajtur ne te thate nje perzierje e ngurte qe permban 1.0g glukonat natriumi, 2.0g  $\text{NaHCO}_3$  dhe 15 mg  $\text{SnCl}_2$ . Nje sasi prej 6.0mg e perzierjes se mesiperme eshte tretur ne 2.0ml solucion  $\text{Na}^{99m}\text{TcO}_4^-$  qe permban 1480MBq (40mCi)  $^{99m}\text{Tc}$  te mjele ne kushte sterile nga gjeneratori  $^{99}\text{Mo} - ^{99m}\text{Tc}$ . Nje alikuote e solucionit te mesiperm, qe permban 740 – 925MBq (20 – 25mCi) te  $^{99m}\text{Tc}$  eshte shtuar ne 0.03 – 0.1mg te derivateve te Bombesines qe studiohen. Perzierja eshte lene ne temperature 37°C per 30 minuta, kohe kjo e mjaftueshme per perfundimin e reaksiionit e shkembimit.

### II. Studimet radiokimike

#### Analiza radiokimike

Analiza radiokimike u realizua me metoden e kromatografise se lenget ne presion te larte (HPLC), me faze te kthyeshme, RP-HPLC, ne nje kollone te tipit  $^{18}\text{C}$   $\mu$ -Bondapack (3.9mm x 300mm). Alikuta prej 10 $\mu\text{l}$  te solucionit te derivateve te Bombesines te shenuara u perdoren per kete metode. Per eluim u zbatua nje sistem gradienti linear me shpejtesi rrjedhjeje

1ml/min, qe permban A: 0.05%TFA (acid trifluoracetik) ne uje dhe B: 60% ACN (acetonitril) ne solventin A, per 20 minuta. Eluenti eshte kaluar permes nje detektori UV ne 220nm dhe permes nje detektori shintilues Nal, te lidhur te dy me nje kompjuter per analizen dhe ruajtjen e te dhenave.

#### ***Stabiliteti in-vitro i derivateve te shenuara***

Per te percaktuar stabilitetin in-vitro te peptideve te shenuara, mostra te shenuara te tyre u lane ne temperature dhome (~20°C) dhe ne frigorifer (~4°C), dhe pas cdo ore u analizuan aliquota nga 10µl me sistemet e pershkruara me siper per rendimentin e shenimit.

### **III. Studimet radiofarmakologjike**

#### **Bioshperndarja ne minj normal**

Per studimet e bioshperndarjes jane perdorur minj te vegjel, me peshe ~ 25g, te seksit femer, zviceriane. Per cdo pike matjeje jane perdorur grupe me nga 5 kafshe. Derivatet e Bombesines te radioshenuara me  $^{99m}$ Tc dhe holluara deri ne aktivitetin e kerkuar me solucion fiziologjik, jane injektuar ne venen e bishtit te cdo miu ne nje vellim jo me te larte se 100µl. Kafshet jane sakrifikuar, pas anestezise me eter, ne intervale kohe te paracaktuara pas injektimit (30, 60, dhe 120min). Jane vecuar organet kryesore, jane peshuar dhe matur per aktivitin e tyre te akumuluar ne to ne nje numerues shintilues gama (Minimax 5000, Packard, USA).

#### **Eksperimenti i bllokimit**

Ky eksperiment kryhet per te provuar nese Derivatet e bombesines se shenuar jane analoge te Bombesines natyrore (native), te pashenuar, pra nese sillen njelloj ne organizem. Injektimi i njekohshem i tyre do te tregoje nese Bombesina natyrore pengon akumulimin e derivateve te Bombesines se shenuar ne pankreas (Bombesina natyrore dhe derivatet e Bombesines te shenuara do te konkurojne njelloj per te arritur receptoret GRP-R).(22)

Keshtu, ne nje grup tjeter kafshesh eshte bashkeinjektuar vellim i njeje (100µl) i Bombesines native (natyrore) dhe peptideve te

shenuar. Keto kafshe jane sakrifikuar 60 minuta pas injektimit. Te dhenat e bioshperndarjes jane llogaritur si perqindje e dozes se llogaritur per peshen (ne gram) te cdo organi.

#### ***Bioshperndarja ne minj me tumor te injektuar***

Nepermjet ketij eksperimenti percaktohet shkalla e akumulimit te derivateve te shenuara ne tumore dhe raporti tumor / jo tumor. Per te realizuar kete eksperiment jane perdorur minj te seksit femer, nude, me peshe afersisht 20g. Tumore eksperimentale jane inokuluar (vaksinuar), ne kofshen e djathte te cdo miu me anen e transplant te qelizave kanceroze prostati PC3 ( $10^7$  qeliza / mi). Tumoret jane lene te rriten per tre javë. Studimet e bioshperndarjes te derivatit te Bombesines te shenuar me  $^{99m}$ Tc jane realizuar pas injektimit intravenoz ne venen e bishtit te cdo miu. Kafshet jane sakrifikuar 1 ore pas anestezise me eter. Tumori eshte ndare vecmas, peshuar dhe matur per aktivitetin e akumuluar ne te. Po ashtu eshte vepruar me pjesen tjeter te trupit.

### **RESULTATE DHE DISKUTIME**

#### **I. Studimi i shenimit te derivateve te Bombesines me $^{99m}$ Tc**

Ne Tabelen 1 jepen strukturat e komplekseve te formuara me radiometalin ( $^{99m}$ Tc).

Derivati i Bombesines	Derivate te pastra Rt (min)	$^{99m}$ Tc-komplekse Rt (min)
<b>BN 1.1</b>	8.71	10.36
<b>BN 1.2</b>	8.33	11.13
<b>BN 1.3</b>	8.99	11.38
<b>BN 1.4</b>	9.35	11.58

**Tab. 1.** Kohet e mbajtjes ne kollonen HPLC te derivateve ne studim

#### ***II. Studimet radiokimike***

##### ***Analiza radiokimike***

Ne Tabelen 1 jepen kohet e mbajtjes ne kollone (Rt) te derivateve te pastra dhe te shenuara.

Sic shihet nga rezultatet e marra nga kjo metode radioshenimi i derivateve te Bombesines me

<sup>99m</sup>Tc con, ne secilin rast, ne formimin e nje komponimi te vetem radioaktiv.

### **Stabiliteti in-vitro i derivateve te shenuara**

Matjet treguan se komplekset ishin stabel deri 6 ore, kur ato ruhen ne temperature dhome, dhe deri ne 8 ore kur ruhen ne frigorifer. Rendimenti i shenimit rezultoi mbi 98%, per secilin rast.in-vitro i derivateve te shenuara

	<b>BN 1.1</b>	<b>BN 1.2</b>	<b>BN 1.3</b>	<b>BN 1.4</b>
<b>Gjaku</b>				
30min	1.2	0.7	1.4	0.6
60min	1.1	2.0	1.8	3.2
120min	0.4	0.4	1.0	0.1
<b>Melci</b>				
30min	2.3	4.1	3.0	3.8
60min	2.7	4.2	1.8	9.6
120min	1.1	1.2	1.9	3.1
<b>Zorret</b>				
30min	2.4	8.7	5.6	9.3
60min	7.3	10.5	3.4	3.3
120min	6.4	9.8	6.4	15.7
<b>Veshkat</b>				
30min	9.2	4.3	11.0	3.7
60min	4.6	5.8	7.2	14.7
120min	3.7	1.6	6.4	0.6
<b>Pankreas</b>				
30min	11.3	7.7	12.8	10.3
60min	5.1	7.3	3.0	6.7
120min	3.6	3.0	6.7	0.6
<b>Urine</b>				
30min	20.4	6.5	26.6	3.9
60min	19.5	20.5	21.8	12.3
120min	33.8	46.0	34.3	23.3

Tab. 2. Bioshperndarja ne minj normal

### **III. Studimet radiofarmakologjike**

#### **Bioshperndarja ne minj normal**

Rezultatet e marra nga ky studim paraqiten ne Tabelen 2. Ato shprehen ne % te dozes se injektuar per peshen ne gram te cdo organi.

Nga rezultatet e marra shihet qarte akumulim i larte i derivateve te peptideve ne pankreas ne 30 minuteshin e pare, krahasuar me organet e tjera. Gjithashtu konstatohet pastrim shume i shpejte

nga gjaku i tyre, permes veshkave ne traktin urinar, pa ndonje mbetje te theksuar ne veshka.

<b>60min</b>	<b>BN 1.1</b>	<b>BN 1.2</b>	<b>BN 1.3</b>	<b>BN 1.4</b>
<b>Gjaku</b>	3.0	2.1	2.7	3.5
<b>Melci</b>	4.4	9.5	3.5	10.0
<b>Zorret</b>	3.8	9.9	2.2	3.3
<b>Veshkat</b>	12.0	20.7	11.8	16.0
<b>Pankreas</b>	1.3	1.8	1.3	1.3
<b>Urine</b>	33.5	1.0	0.6	0.5

Tab. 3. Eksperimenti i bllokimit

#### **Eksperimenti i bllokimit**

Ne Tabelen 3 paraqiten rezultatet e marra nga ky studim.

Duke krahasuar keto rezultate me ato te Tabeles 2, per kohen 60 minuta, arrijme ne perfundimin se prania e Bombesines natyrore (ne vellim te larte) krahas asaj te shenuar realizon bllokimin e akumulimit te derivateve te shenuara ne pankreas. Kjo verteton edhe nje here faktin se ato konkurojne njelloj per receptoret GRP, pra jane analoge te njeri-tjetrit.

<b>Derivati i Bombesines</b>	<b>Akumulimi ne tumor (%ID/g)</b>	<b>Raporti tumor / jo tumor</b>
<b>BN 1.1</b>	15.2	29.1
<b>BN 1.2</b>	14.9	28.3
<b>BN 1.3</b>	15.7	30.0
<b>BN 1.4</b>	15.6	29.5

Tab. 4. Bioshperndarja ne minj me tumor te injektuar

Rezultatet e bioshperndarjes jane llogaritur ne %ID/g (perqindje e dozes se injektuar per g organ te trupit te miut). Rezultatet e marra jepen ne Tabelen 4.

Sic shihet nga keto rezultate akumulimi i derivateve te Bombesines ne tumor eshte i kenaqshem dhe po ashtu rapporti tumor / jo tumor. Nuk verehet ndonje diferenca e dukshme midis derivateve me njeri tjetrin. Ato sllen pothuajse njesoj biologjikisht.

**PERFUNDIME**

Rezultatet e ketij studimi tregojne se seria e derivateve te Bombesines e analizuar me ane te metodave analitike, shfaq veti kimike dhe biologjike te ngjashme me ato te Bombesines natyrore dhe keto derivate kane veti premtuese per t'u perdorur si nje radiofarmaceutikat specifik, i ri, per zbulimin e tumoreve te pankreasit:

1. Shenimi i derivateve te Bombesines me  $^{99m}\text{Tc}$  con ne formimin e nje komponimi radioaktiv te vetem, qe shfaqet si nje pik i vetem gjate kontrollit me sistemin HPLC.

2. Keto komponime mbeten stabel deri ne 6 ore pas shenimit kur ruhen ne temperature dhome dhe deri ne 8 ore pas shenimit kur ruhen ne frigorifer, kohe kjo e mjaftueshme per studime shintigrafike.

3. Bioshperndarja ne kafshe tregon per nje pastrim (largim) te shpejte nga gjaku, kryesisht permes veshkesh, per ne traktin urinar.

4. Bioshperndarja ne minj normale tregon se akumulimi ne pankreas eshte i larte dhe specifik.

5. Eksperimentet e blokimit tregojne se derivate e Bombesines ne studim jane analoge te Bombesines natyrore. Ato konkurojne njelloj per te kapur receptoret GRP-R.

6. Krasimet midis 4 derivateve nuk tregojne ndonje diferenca te dukshme midis tyre, gje qe i jep atyre mundesine per t'u perdorur me sukses si radiofarmaceutikate te pershtatshem ne diagnostikimin e kancerit te hershem ne pankreas.

**BIBLIOGRAFIA**

1. Breemen W.A.P., Hofland L.J., de Jong M., Bernard B.F., Sinivasan A., Kwekkeboom D.J., Visser T.J. and Krenning E.P. (1999) Evaluation of radiolabeled bombesin analogues for receptor-targeted scintigraphy and radiotherapy. *Int J Cancer*, 81(4), 658-665
2. Costopoulos B., Varvarigou A. D., Sivolapenko G., Potamianos S., Scopinaro F. And Archimandritis S.C. (1997) Radiochemical and radiobiological evaluation of a synthetic peptide labelled with  $^{99m}\text{Tc}$ . *Nucl. Med. Commun.* 18, 474-481
3. La Bella R., Garcia-Garayoa E., Langer M., Blauenstein P., Beck-Sickinger A.G. and Schubiger PA. (2002) In vitro and in vivo evaluation of a  $^{99m}\text{Tc}(\text{I})$ -labeled bombesin analogue for imaging gastrin releasing peptide receptor-positive tumors. *Nucl Med Biol*, 29, 553-560
4. Mantey S., Frucht H., Coy D.H., and Jensen R.T. (1993) Characterization of Bombesin Receptors Using a Novel, Potent, Radiolabeled Antagonist That Distinguishes Bombesin Receptor Subtypes. *Molecular Pharmacology*. 43, 762-774
5. Nock B., Nikolopoulou A., Chiotellis E., Loudos G., Maintas D., Reubi J.C. and Maina T.(2003) [ $^{99m}\text{Tc}$ ]Demobesin 1, a novel potent bombesin analogue for GRP receptor-targeted tumor imaging. *Eur J Nucl Med*. 30, 247-258
6. Van de Wiele C., Dumont F., Vanden Broecke R., Oosterlinck W., Cocquyt V., (2002) A GRP analogue for visualisation of GRP receptor-expressing malignancies: a feasibility study. *Eur J Nucl Med*, 27, 1694-1699.